

Në bazë të nenit 54, paragrafi (1), pika 1.21 dhe nenit 78 paragrafi (1) të Ligjit të Energjetikës\* "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/25 dhe 135/25) dhe nenit 18 paragrafi (1) pika 1. të Rregullores së Licencave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 40/26), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2026, solli këtë

**VENDIM**  
**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË ENERGETIKE**  
**PRODHIM TË ENERGISË ELEKTRIKE**

1. Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike BIG SOLAR SHPKNJP Shkup, i jepet licencë për ushtrimin e veprimtarisë energjetike të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali elektrik diellor CED "BIG SOLAR 4".
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë energjetike të prodhimit të energjisë elektrike, është dhënë në shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij dhe publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen zyrtare të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**PA1 nr. 12-228/26**  
**19 qershor 2026**  
**Shkup**

**Kryetari**  
**i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të**  
**Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të**  
**Menaxhimit me Mbeturina Komunale të**  
**Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
**Ацо Ристов**

**Shtojcë:**

**LICENCË  
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË ENERGJETIKE  
PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**1. Emri dhe selia e bartësit të licencës:**

Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike BIG SOLAR SHPKNJP Shkup, me seli në rr. "Naroden Front" nr. 23-4/1 Shkup-Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut.

**2. Veprimtaria energjetike, për të cilën jepet licenca:** Prodhimi i energjisë elektrike

**3. Data e dhënies së licencës:** 19 qershor 2026

**4. Data e skadimit të licencës:** 19 qershor 2061

**5. Numri evidentues i licencës së dhënë:** EE-ПРОИЗ-1934-2026

**6. Numri amzë:** 7689268

**7. Numri tatimor:** 4080023616562

**8. Rajoni ku ushtrohet veprimtaria energjetike**

Bartësi i licencës e ushtron veprimtarinë energjetike prodhim të energjisë elektrike nga centrali elektrik diellor CED "BIG SOLAR 4" në PK nr.566/6, KK Dollan, komuna e Shtipit.

**9. Vendi i dërgesës:**

Dërgesa e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga centrali elektrik diellor CED "BIG SOLAR 4" do të bëhet në përputhje me kushtet e definuara për lidhje në aktvendimin për miratimin e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike PA1 nr. NCC\_17\_20240816\_150 datë 2 tetor 2024, të dhënë nga Elektrodistribucioni SHPKNJP, Shkup, me fuqi të miratuar kulmore si prodhues prej 4 290 kW.

**10. Detyrimet e përgjithshme për bartësin e licencës**

Bartësi i licencës është i detyruar:

- të sigurojë prodhim dhe dërgesë të sigurt, të vazhdueshme dhe cilësore të energjisë elektrike deri në pikën e pranimit në sistemin e shpërndarjes ose të transmetimit të energjisë elektrike,
- ta shesë energjinë elektrike të prodhuar,
- të ofrojë shërbime sistimore për operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike për balancimin e sistemit, në përputhje me rregullat e përcaktuara të tregut të energjisë balancuese në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike dhe me rregullat e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike,

- të mundësojë qasjen deri te sasi të energjisë elektrike dhe/ose shërbimet sistemore, të përcaktuara në marrëveshje, deri te pika e pranimit në sistemin e shpërndarjes ose të transmetimit të energjisë elektrike në përputhje me kushtet dhe detyrimet në licencë si dhe me marrëveshjen për lidhje,
- t'i mirëmbajë në gjende operative të gjitha resurset e nevojshme teknike, përfshirë edhe pajisjet e telemetrisë për prodhim rrjedhës,
- t'i dërgojë raporte, të dhëna dhe informata operatorit të sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me rregullat e rrejtit,
- t'i dërgojë operatorit të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë si dhe operatorit të tregut të energjisë elektrike, të dhëna dhe informata të marrëveshje për blerje dhe shitje të energjisë elektrike, disponueshmërinë e kapacitetit prodhues dhe/ose shërbimeve sistemore, me përjashtim të të dhënave afariste-financiare,
- të pajiset me të gjitha resurset e nevojshme teknike për dërgimin e informatave deri te operatori përkatës i sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes, përfshirë edhe pajisjet për matje në largësi të prodhimit në kohë reale.
- ka të drejtë të blejë energji elektrike në tregun e energjisë elektrike, të mundësojë burime të tjera të energjisë si dhe të ndërmarrë aktivitete të tjera në tregjet e energjisë për optimizimin e prodhimit të tyre dhe shpenzimeve të punës, me përjashtim të prodhuesit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, i cili përdor tarifë preferenciale,
- t'i ruajë të gjitha të dhënat sëpaku pesë vite, të cilat i referohen punës së centraleve elektrike, prej të cilave mund të përcaktohen dhe të kontrollohen, për secilën orë, të gjitha vendimet operative në lidhje me dispeçimin dhe pjesëmarrjen e tij në tregjet e energjisë elektrike, ku përfshihen edhe të dhënat për kapacitetet prodhuese që janë në dispozicion dhe shërbimet sistemore të ofruara dhe të aktivizuara në nivel të centralit elektrik në periudhat e tregtisë dhe prodhimit, si dhe për pjesëmarrjen në ankande për kapacitetet interkonektuese, vetëm në rastet kur prodhuesi i energjisë elektrike është pronar dhe/ose menaxhon me centralin elektrik me fuqi të instaluar të barabartë ose më të madhe se 200MW, ose posedon më shumë centrale elektrike me fuqi të përgjithshme të instaluar të barabartë ose më të madhe se 400 MW,
- të mundësojë këqyrje të të dhënave për centralet elektrike, të cilat kanë fuqi të barabartë ose më të madhe se 200 MW, ose më shumë centrale elektrike me fuqi të përgjithshme të instaluar, të barabartë ose më të madhe se 400 MW, për Komisionin Rregullator të Energjetikës, për Sekretariatit e Komunitetit Energjetik në përputhje me detyrimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, si dhe për Komisionin e Mbrojtjes së Konkurrencës në përputhje me rregullat, sipas të cilave rregullohet mbrojtja e konkurrencës,
- që Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht Komisionit të Mbrojtjes së Konkurrencës, në përputhje me dispozitat, me të cilat rregullohet mbrojtja e konkurrencës, t'iu mundësojë këqyrje në të dhënat, të cilat i referohen të gjitha transakcioneve të tij të shitblerjes së energjisë elektrike dhe derivativet, përfshirë edhe derivativet e tregut financiar, me blerësit me shumicë, si dhe me operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike ose operatorit të tregut të energjisë elektrike, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit,
- të mos e prishë cilësinë e energjisë elektrike në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike,
- t'i sigurojë operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, operatorit të tregut të energjisë elektrike, operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të gjitha informatat e nevojshme dhe të dhënat që janë të domosdoshme për ushtrimin e detyrimeve të tyre që rrjedhin

- nga licencat, në përputhje me Rregullat e Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, Rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike,
- të dërgojë të dhëna dhe informata në përputhje me Rregulloren e Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkcionimit të Tregjeve të Energjisë,
  - të udhëheqë kontabilitet të veçantë për secilën veprimtari energjetike veçmas, që e ushtron apo për veprimtari të tjera që i ushtron, në përputhje me nenin 5 të Ligjit të Energjetikës\*,
  - të dërgojë njoftime për të gjitha rrethanat, ngjarjet dhe ndryshimet, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim në ushtrimin e veprimtarisë energjetike,
  - t'i respektojë ligjet, rregullat e tjera dhe aktet e përgjithshme, të cilat i referohen ushtrimit të veprimtarisë energjetike, mbrojtjes së konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjes gjatë punës,
  - të mundësojë qasje të drejtpërdrejta me kërkesë të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dokumentacionin e përgjithshëm që i referohet kryerjes së veprimtarisë energjetike për të cilën është dhënë licenca, në pajtueshmëri me Rregulloren e Licencave.

#### **11. Detyrimi për dërgimin e Raportit Vjetor të Punës**

Bartësi i licencës është i detyruar që, t'i dërgojë Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, raportin vjetor të punës për vitin paraprak në përputhje me rregulloren e mënyrës dhe të procedurës për përcjelljen e funksionimit të tregjeve të energjisë.

#### **12. Konfidencialiteti i informatave**

Bartësi i licensës është i detyruar që në pajtueshmëri me ligjin, të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave afariste dhe informatave gjatë ushtrimit të veprimtarisë energjetike, prodhim të energjisë elektrike.

#### **13. Cilësia e shërbimit**

Bartësi i licencës është i detyruar të sigurojë mjete teknike dhe kushte të tjera, të cilat do të mundësojnë cilësi të vazhdueshme të energjisë elektrike të prodhuar dhe me kërkesë të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të dërgojë raport me shkrim për lëvizjen e të gjithë parametrave që e përcaktojnë cilësinë e energjisë elektrike të prodhuar në periudhën e përcaktuar kohore.

#### **14. Matja e energjisë elektrike dhe e fuqisë së prodhuar**

Matja e energjisë elektrike të prodhuar, gjegjësisht të dërguar në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike, bëhet në vendin matës përlogaritës në mënyrë dhe procedura të përcaktuara në përputhje me Rregullat e Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, respektivisht me Rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

#### **15. Ndryshimi, vazhdimi, bartja, ndërprerja, pezullimi dhe heqja e licencës**

Ndryshimi, vazhdimi, bartja, ndërprerja, pezullimi dhe heqja e kësaj licence do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Energjetikës\* dhe Rregullores së Licencave.

#### **16. Masat në rast të mosplotësimit të detyrimeve nga bartësi i licencës**

Nëse bartësi i licencës nuk i plotëson kushtet e përmbajtura në këtë licencë, Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës

së Maqedonisë së Veriut do të marrë masa në përputhje me Ligjin e Energjetikës\* dhe Rregulloren e Licencave.

#### **17. Kapacitetet prodhuese, me të cilat ushtrohet veprimtaria energjetike**

Bartësi i licencës e ushtron veprimtarinë energjetike, prodhim të energjisë elektrike nga centrali elektrik diellor, me karakteristikat teknike në vijim:

- a) emri i centralit elektrik diellor: CED "BIG SOLAR 3"
- b) fuqia e centralit elektrik diellor sipas paneleve fotovoltaike: 4 784,7 kW
- c) fuqia e centralit elektrik diellor sipas invertorëve: 3 800 kW
- d) fuqia e miratuar e OSSH: 4.290 kW ose 3708,66 kW varësisht prej realizimit të rritjes së fuqisë në TS 110/35/10(20)kV Shtip 2
- e) viti i fillimit dhe mbarimit të ndërtimit dhe fillimi i punës: viti 2025
- f) jetëgjatësia e paraparë e CED: 35 vite
- g) lloji dhe prodhuesi, fuqia dhe numri i paneleve fotovoltaike:
  - JA SOLAR JAM66D45 615/LB, 7.780 panele me fuqi prej 615 W
- h) lloji dhe prodhuesi, fuqia dhe numri i invertorëve:
  - HUAWEI SUN200 330KTL-H1-330kW, 10 invertorë me fuqi prej 300 kW
  - HUAWEI SUN200 215KTL-H1-215kW, 4 invertorë me fuqi prej 200 kW
- i) rrezatimi vjetor diellor në atë lokacion: 1590,23 kWh/m<sup>2</sup>
- j) prodhimi i pritur vjetor i energjisë elektrike: 7 125 MWh